



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA E GJYKATËS DEÇAN

Numri i lëndës: 2020:005655

Datë: 10.05.2024

Numri i dokumentit: 05712856

GJYKATA THEMELORE NË PEJË DEGA NË DEÇAN, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, me gjyqtarin Fatmir Dobraj, në çështjen juridike-kontestimore të paditëses: B.... K.... e S..... me seli në Prishtinë ,të cilën e përfaqëson, përfaqësuesi i autorizuar Freskim Riza nga Prishtina, sipas autorizimit, Kundër të paditurit: V.... H..... L.... nga fshati P.... K.D....., të cilin e përfaqëson përfaqësuesja e përkoheshem G..... D..... D.....Baza Juridike: Rimbursim dëmi, Vlera e kontestit: 1236 € (njëmijë dyqind e tridhjetë e gjashtë euro), në prezencën e të autorizuarit të paditëses, e ne prezencën e përfaqësueses së përkohesheme të paditurit, në seancën publike të shqyrtimit kryesor, me datë 29/04/2023, dhe përpiluar me datë 10/05/2024 bie:

A K T G J Y K I M

APROVOHET NË TËRËSI E BAZUAR, kërkesë padia e paditëses: B.... K.... S..... me seli në Prishtinë,

I. DETYROHET i padituri: V.... H..... L..... nga fshati P..... K.D....., që paditëses në emër të rimbursimit të dëmit, për aksidentin e dt. 31.07.2018, ti paguaj shumën në lartësi 1,236.00 € (njëmijë e dyqind e tridhjetë e gjashtë euro), gjitha këto kamatën prej 8%, nga paraqitja e padisë date 17.01.2020 të gjitha ato ne afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit e aktgjykimit e nën kërcenim të përmbarimit me dhunë.

II.OBLIGOHET i padituri të ia paguajë shpenzimet e procedurës paditësit në shumën prej 30€ (tridhjetë) euro për taks gjyqësore ,dhe shpenzimet tjera ne shumë prej 239 euro (dyqind e tridhjetë e nëntë euro)ne shume të përgjitheshme prej 269 euro ti përmbush në afat prej 15 dite, nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi ne dorëzim e nën kërcenim të përmbarimit me dhunë.

A r s y e t i m

Paditësja ka ushtruar padi në këtë Gjykatën Themelore në Pejë, me datë 17.01.2020 me të cilën kërkon nga i padituri rimbursimin e dëmit në në lartësi prej 1236 € (njëmijë e dyqind e tridhjet e gjashtë euro), e duke parashtruar gjendjen faktike si vijon:se me dt. 31.07.2018 në ora 14:30 me Opel Combo, me targa të regjistrimit 03-785-CG ka shkaktuar aksident

trafiku me çrast automjeti me të cilin paditur kishte shkaktuar aksident pala S..... S....j dhe D... S..... ka pësuar lëndime trupore dhe dëme materiale. I padituri në këtë aksident ka qene i pa mbules sigurimi , respektivisht kishte skaduar afati i periudhës së sigurimit .

Meqë dëmtuarit Sh.... S..... dhe D..... S..... kishin kerkuar dëmshpërblimin e dëmit me q"rast paditesja kishte kompensuar këtu të dëmtuarit ne këtë aksident në shumën e cekur si me lartë.

E autorizuar e paditëses si në fillim të shqyrtimit të kësaj çështje juridiko-kontestimore ashtu edhe në fjalën përfundimtare thekson : ka mbetur pranë deklarimeve dhe pretendimeve të daluara nga kjo padi, bazuar konsiderojmë se u vërtetua baza juridike e përgjegjesisë të shkaktarit të aksidentit, Andaj gjykatës i propozojmë qe të beje administrimin e provave, Andaj gjykatës i propozoj qe ta aprovoj ne tërësi padinë e paditësit dhe ta detyroj të paditurin V.... L..... e paditëses t'ia rimbursojë shumen ne vlerën prej 1236 euro, të shkaktuar ne aksidentin e dt.31.07.2018 dhe atë me kamate ligjore duke e llogaritur nga dita e ngritjes të kësaj padise e gjere ne pagesën përfundimtare si dhe shpenzimet për procedurë takse ne vlerën prej 30 euro.

Gjykata për ti krijuar kushtet procedurale në këtë çështje kontestimore ne kuptim të nenit 79 parg 3 pika a) të Ligjit të Procedurës Kontestimore të Kosovës, të paditurit : V..... L.... nga fshati P..... K.D.....,tani me adresë të panjohur, ia caktoj përfaqësuesin e përkohshëm avokat.G..... D..... nga D..... me qellim të mbrojtjes se interesit të tij ne këtë procedure kontestimore,i cili aktvendim u publikua ne gazetën zyrtarë me dt.13.03.2024 dhe me dt.13.03.2024, është afishuar në tabelën e shpalljeve në gjykate, është kërkuar edhe ne rruge tjera vetem të sigurohet adresa,por prap ka qen e pa mundur.

Përfaqësuesja e përkoheshme ka deklaruar se ka berë përpjekje për të gjetur të paditurën mirpo perpjekajt kan rrezultuar të kota.Dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se nga ajo qe tha deri tani e kundershtoje kërkes padinë e paditesit dhe ja le në vlersim gjykates.

Gjykata me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike lidhur me këtë çështje kontestimore ka administruar provat : Shikohen të gjitha shkresat të bashkangjitura nga Byroja Kosovare e Sigurimeve, leximin e transferit bankare përmes bankës ekonomike të datës 21.11.2-18,Leximin e procevrbalit ne vendshiqim ne vend të aksidentit ,raportin i policisë drejtuar prokurorisë Themlore Pejë të datës 12.08.2018 DR 3004-18 shiqimi e konfirmimit i sigurimit ne emer të V....L..... me valeditet e datës 13.04.2014 Shikimin e Raportit të spitalit të përgjithshëm ne Pejë me nr të protokollit 15226 ne emer të D.....S..... 1-2 faqe.

Pasi që gjykata bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç, dhe të gjitha së bashku e në lidhmëni njëra me tjetrën, e duke u mbështetur në dispozitat e nenit 8, të Ligjit për Procedurën Kontestimore, arriti në përfundim se në këtë çështje juridike - civile duhet vendosur si në dispozitiv, të këtij aktgjykimi, pasi që:

Për gjykatën nuk ishte kontestuese se me dt. 31.07.2018 në ora 14.30 me automjetin Opel Combo, me targa të regjistrimit 03-785-CG ka shkaktuar aksident trafiku në Pejë me ç,rast automjeti me të cilin paditur kishte shkaktuar aksident pala Sh.... S.....dhe D..... S..... ka pësuar lëndime trupore dhe dëme materiale.

Për gjykatën nuk ishte kontestuese se paditura ne atë kohë Byroja Kosovare e Sigurimit tani si paditëse në kishin arritur ujudi jashtë gjyqesore me dt. 14.11.2018 me numër FK -

1063/2018 Sh.... S..... dhe D..... S.... e datës 07.12.2018 me nr FK 1078/2018 ku ishte kompensuar demi jo material.

Gjykata për vërtetimin e gjendjes faktike ka nxjerrë edhe raportin e policisë nga lëmia e Komunikacionit i cili ne konkludim e tij ka ardhur ne përfundim se duke u bazuar në analizën e mendimin e berë me lartë me rastin e këtij aksidenti jep këtë përfundim , deri të aksidenti ka ardhur për shkak të lëshimit të ngasësit të automjetit “A” Opel Combo” me ngjyrë të bardhe dhe ato janë : Mos kujdesi i duhur gjatë ngasjes së automjetit ,mos përshtatja e shpejtësisë së lëvizjes ne rrugë,deh duke mos embajtur skajn e rrugës nga e terë kjo që kamë cekur me lartë kam arritur ne përfundim se shkaktari i aksidentit ka qene ngasësi “A”. sepse sipas gjykatës e cila është berë në menyrë profesional ku janë përdorur per vlerësimin e rrjedhjes se aksidentit dhe se është nxerrur nga person zyrtare.

Gjykata gjeti se baza juridike e kërkesë padisë është e bazuar dhe vendosi si në pikën **I** , që i padituri është përgjegjëse për rimbursimit e dëmit paditëses gjejnë mbështetje të LIGJI NR. 04/L-018, Ligjit për Auto Përgjegjësinë nenit 14 par 1 pika 1.2 “Drejtuesi nuk ka leje të vlefshme dhe adekuate për drejtim të mjetit motorik, përveç rasteve të përdorimit të mjetit motorik gjatë mësimeve të drejtimit të mjetit nga kandidati, sipas të gjitha rregullave të përcaktuara për procesin e mësimit; “ këtu kemi të bëjmë me humbje të mbulesës siguroese dhe njëkosishtë për drejtën e paditesës për regresi të mjeteve nga paditësit të paguara palëve të treta për zhdëmtim. Nenit 14 pika 3 i cili thotë “ Siguruesi pas përmbushjes së detyrimit nga ky nen dhe paragrafi 3. i nenit 9 të këtij ligji, ka të drejtë të kërkojë Rimbursim në procedurë regresi ndaj personit përgjegjës për dëmshpërblimin e paguar, edhe pse personi nuk kishte mbulesë siguroese.”, ne këtë rast gjykata vlerëson se lind detyrimi per regres. E lidhur me dispozitën e nenit 262 parag.1 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve. Sepse paditësja është dashur ta kompensoj dëmin të dëmtuarit në aksidentin e komunikacionit rrugor të datës 31.07.2018, sepse ne ditën e aksidentit i padituri nuk ka qenë i siguruar tek dhe BKS-ja dhe në bazë të kontratës mbi sigurimin e autopërgjegjesisë ka berë kompensimin e dëmit ndaj të dëmtuarve, andaj gjykata vlerëson si të bazuar .

Sipas dispozitës së nenit 7 të ligjit për procedurën kontestimore, palët kanë për detyrë ti paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta, dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla, ndërsa sipas dispozitës së nenit 319 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, secila palë ndërgjyqës, ka për detyrë ti provoi faktet mbi të cilat i bazon kërkimet dhe pretendimet e veta.

Andaj, gjykata e vënë para një situate të tillë dhe duke u bazuar në këtë gjendje faktike erdhi në përfundim dhe vërtetoi se ekziston detyrimi i të paditurit, ndaj paditëses për rimbursimin e dëmit, në shumën prej 1,236 euro (njëmijë e dyqinde e tridhjet e gjashtë euro), e duke u mbështetur në dispozitat e nenit 262 paragraf 1, të Ligjit mbi Marrëdhëniet të Detyrimeve, i cili shprehimisht parasheh se kreditori në marrëdhëniet e detyrimeve, është i autorizuar që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë të përmbush detyrimin me ndërgjegje dhe në tërësi sikur është përmbajtja e tij, dhe si rezultat i kësaj paditësja ka paguar në tërësi dëmin që e ka shkaktuar i padituri, me ç

‘rast i padituri ka hyrë në raport të detyrimeve me paditësen, në të cilin raport paditësja e ka cilësinë e kreditorit kurse i padituri e ka cilësinë e debitorit.

Gjykata murr parasysh edhe pretendimet e përfaqesuse së përkoheshem të paditurit. mirëpo gjykata duke u mbështetur ne provate të cili potencon se shkaktar kryesor ka qene këtu padituri , gjykata nuk u lëshuar që ti bejë një analizë të posaçme pretendimet e përfaqësuesit .

Lidhur me kamatën konform shumave të aprovuara për kompensim të dëmit material dhe jo material gjykata ka vendosur duke u bazuar në nenin neni 382 të LMD-së, ku thuhet se: “*Debitori që vonon në përmbushjen e detyrimit në të holla debiton, përpos borxhit kryesor edhe kamatën si dhe lartësia e kamatëvonesës është tetë përqind (8%) në vit, përveç nëse parashihet ndryshe me ligj të veçantë*”, bazuar në Mendimin Juridik për Kamatën të Gjykatës Supreme të Kosovës nr. 265/2020 të datës 02.12.2020, pasi që në rastin konkret pala e paditur është vonuar në përmbushjen e obligimit ndaj palës paditëse dhe se në këtë rast kemi të bëjmë me dëm material.

Vendimin lidhur me shpenzimet e procedurës, gjykata e ka mbështetur në dispozitat e nenit 449, 452 e lidhur me datë, 463 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, të paditurin e detyroi që të paguajë shpenzimet e procedurës dhe atë për taksë shumen prej 30 euro,dhe shpenyet për përfaqesuses të përkoheshem.ne shume të përgjithshem 269 euro

NGA GJYKATA THEMELORE NË PEJË DEGA DEÇAN, Cnr 16/2020 me dt. 10/05/2024

G j y q t a r
Fatmir Dobraj

Udhëzim Juridik:

Kundër këtij Aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, nga dita e marrjes në dorëzim, nëpërmjet kësaj Gjykate për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.